



**KOMUNA E GAZI BABËS
SHPALLJA numër 02/2023**

për tjetërsimin e tokës së rregulluar ndërtimore të pandërtuar në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet ankandit publik elektronik për ndërtim

**të A1-banimeve familjare në shtëpitë familjare dhe A2-banimeve në pallatet e banimit
LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK**

Lëndë e ankandit publik elektronik është toka e rregulluar ndërtimore e pandërtuar, pronë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e paraparë me PDU për Maxhari - Hipodrom të miratuar me Vendimin nr. 07-293/3, të datës 29.01.2008, e cila tokë e rregulluar ndërtimore e pandërtuar është pjesë e bllokut 3 dhe pjesa e bllokut 4 me qëllim ndërtimin e A1 - banimit në shtëpi familjare dhe një pjesë e bllokut 11 me qëllim ndërtimin e A2 - banesave në ndërtesa banimi, sipas pasqyrës tabelore, në të cilën janë dhënë të dhëna për parcelën ndërtimore, qëllimin e parcelës ndërtimore, sipërfaqen totale të parcelës, katet, sipërfaqen e ndërtimit, lartësinë maksimale deri në kornizë, përqindjen e ndërtimit, koeficientin e shfrytëzimit, çmimin fillestar për m², çmimin e përgjithshëm fillestar dhe garancinë bankare për seriozitetin e ofertës.

Pasqyra tabelore:

Nr. i ankandit	Nr. i parcelës ndërtimore	Qëllimi i parcelës ndërtimore	Numri i kat. parcela (të gjitha KK Maxhari)	Sip. e parc. ndërtimore (m ²)	Sipërfaqja e ndërtimit(m ²)	Sipërfaqja maksimale e zhvilluar (m ²)	Koef. e shfrytëzimit	Përq. e ndërtimit (%)	Lartësia maksimale deri në kornizë dhe katet (m)	Çmimi fillestar për m ² (denarë)	Vlera e përgjithshme fillestare (denarë)	Garancia bankare për seriozitetin të ofertës (denarë)
01/2023-3.13	3.13	A1-banim familjar në shtëpi familjare	P.K.nr. 2142/106	617	291	873	1.42	47	10.20/ P+2	61,00	37.637,00	75.274,00
01/2023-4.34	4.34	A1-banim familjar në shtëpi familjare	P.K.nr. 2142/100	345	118	354	1.03	34.20	10.20/ P+2	61,00	21.045,00	60.000,00
01/2023-4.35	4.35	A1-banim familjar në shtëpi familjare	P.K.nr. 2142/102	345	118	354	1.03	34.20	10.20/ P+2	61,00	21.045,00	60.000,00
01/2023-4.36	4.36	A1-banim familjar në shtëpi familjare	P.K.nr. 2142/103	294	154	462	1.57	52.28	10.20/ P+2	61,00	17.934,00	60.000,00
02/2023-11.4	11.4	A2 - banim në ndërtesa banimi	P.K.nr. 1978/25	3355	483	3864	1.15	14	25,20/P+7	2.400,00	8.052.000,00	8.052.000,00
02/2023-11.5	11.5	A2 - banim në ndërtesa banimi	P. K.nr. 1978/26 P. K.nr. 1980/3	2824	483	3864	1.37	17	25,20/P+7	2.400,00	6.777.600,00	6.777.600,00
02/2023-11.6	11.6	A2 - banim në ndërtesa banimi	P. K.nr. 1978/22 P. K.nr. 1980/7 P. K.nr. 1981/2	3053	483	3864	1.27	16	25,20/P+7	2.400,00	7.327.200,00	7.327.200,00

Të drejtën e pjesëmarrjes në ankand publik kanë:
1. Personat fizikë: shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD-së, si dhe shtetas të shteteve që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD-së dhe në kushte reciprociteti mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Persona juridikë: person juridik vendor, person juridik në pronësi të përzier, person juridik i themeluar nga person fizik dhe juridik i huaj, i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, persona juridikë të huaj rezidentë në shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe OECD, si dhe persona juridikë të huaj rezidentë në vende që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD-së dhe të cilët në kushte reciprociteti mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PROCEDURA

- Përmes sistemit elektronik www.gradezno-zemjiste.mk, Komisioni i njofton parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e fletëparaqitjeve në mënyrë elektronike, në afat prej 24 orëve pas skadimit të afatit për dorëzimin e të njëjtave, ndërsa parashtruesit të fletëparaqitjeve që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë automatikisht u dorëzojnë një emër përdoruesi dhe fjalëkalimin për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, ndërsa parashtruesit të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë u dërgon Njoftim ku i njofton se të njëjtat nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
- Parashtruesit e fletëparaqitjeve duhet të kenë një certifikatë dixhitale (nënshkrim) në mënyrë që të mund të dorëzojnë fletëparaqitje elektronike dhe të marrin pjesë në ankandin publik elektronik.
- Në ditën e mbajtjes së ankandit publik elektronik, pjesëmarrësit hyjnë në faqen e internetit me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që kanë marrë në adresën e postës elektronike të dorëzuar krahas fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankand publik elektronik.
- Ankand publik elektronik mund të fillojë me të paktën një pjesëmarrës në ankandin publik.
- Ankand publik elektronik monitorohet nga Komisioni për zbatimin e procedurave të ankandit publik, i themeluar nga Kryetari i Komunës së Gazi Babës.
- Ankand publik elektronik fillon me shpalljen e çmimit fillestar për metër katror dhe realizohet me ofertim nga ana e pjesëmarrësve.
- Për parcelat ndërtimore me qëllim të A1-banimit në shtëpi familjare, licitacioni kryhet "hap pas hapi" me rritje të vlerës me çdo "hap" jo më pak se 10,00 denarë në numër të plotë pa decimale.
- Për parcelat ndërtimore me qëllim të banimit A2 - banim në ndërtesa banimi, licitacioni bëhet "hap pas hapi" me rritje të vlerës me çdo "hap" jo më pak se 234,00 denarë në numra të plotë pa decimale.
- Ankand publik elektronik konsiderohet i përfunduar në momentin e skadimit të kohës së përcaktuar në këtë Shpallje dhe nëse brenda dy minutave të fundit është bërë ofertë nga pjesëmarrësit, afati për përfundimin e ankandit publik zgjatet edhe për dy minuta të tjera. Ankand publik vazhdon në një numër të pakufizuar herë për aq kohë sa një ofertë bëhet nga pjesëmarrësit në fund të dy minutave të fundit.
- Për një procedurë të ankandit publik të zhvilluar me sukses, është e nevojshme që të ketë të paktën një ofertë të njëpasnjëshme mbi çmimin fillestar për metër katror.
- Pjesëmarrësit i ankandit publik që ka ofruar çmimin më të lartë fiton statusin e ofertuesit më të favorshëm.
- Pas përfundimit të ankandit publik, komisioni përgatit procesverbalin e ankandit publik të zhvilluar dhe ia dorëzon atë në mënyrë elektronike të gjithë pjesëmarrësve të ankandit publik.
- Pas përfundimit të procedurës së ankandit publik, Komisioni është i obliguar që në afat prej 3 (tri) ditësh pune të paraqesë kërkesë për mendim pranë Avokatit të shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me draft tekstin e kontratës për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është e obliguar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i kërkesës për mendim, të paraqesë mendim lidhur me draft tekstin e kontratës për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nëse Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk paraqet mendim në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, ai do të konsiderohet pozitiv.
- Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Avokati i shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni në afat prej 3 (tri) ditësh pune i dërgon njoftimin për përgjydhjen e ofertuesit më të favorshëm ofertuesit më të favorshëm.
- Ofertuesi më i favorshëm është i detyruar që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së Njoftimit se është ofertuesi më i favorshëm i ankandit publik, të paguajë mjetet sipas çmimit përfundimtar të ankandit, të paguajë shpenzimet e procedurës në vlerë prej 10% të garancisë bankare për seriozitetin e ofertës por jo më shumë se 15.000,00 denarë, t'i dorëzojë Komisionit dëshmitë origjinale të bashkangjitura me kërkesën dhe të dorëzojë dëshminë e pagesës së bërë në përputhje me çmimin përfundimtar të ankandit dhe kostot e paguara të procedurës.
- Nëse ofertuesi më i favorshëm nuk paguan mjetet në përputhje me çmimin përfundimtar të ofertimit brenda afatit të caktuar, nuk paguan shpenzimet e procedurës në masën 10% të garancisë bankare për seriozitetin e ofertës, por jo më shumë se 15.000,00 denarë, nuk i dorëzon Komisionit dëshminë origjinale të bashkangjitur kërkesës dhe nuk ofron dëshmi për pagesën e bërë në përputhje me çmimin përfundimtar të ankandit dhe shpenzimet e paguara të procedurës, do të konsiderohet se toka ndërtimore nuk është tjetërsuar, nuk do të afrohet lidhja e marrëveshjes së tjetërsimit, aktivizohet garancia bankare për seriozitetin e ofertës dhe nuk do të mund të marrë pjesë në asnjë ankand publik të ardhshëm për parcelën ndërtimore në fjalë.
- Nëse ofertuesi më i favorshëm i paguan mjetet në përputhje me çmimin përfundimtar të ankandit brenda afatit të caktuar dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur nuk mund të lidhet një marrëveshje, mjetet e paguara në përputhje me çmimin përfundimtar nuk i kthehen atij, do të konsiderohet se toka ndërtimore nuk është tjetërsuar, nuk do të afrohet me lidhjen e marrëveshjes së tjetërsimit, garancia bankare për seriozitetin e ofertës aktivizohet dhe nuk do të mund të marrë pjesë në asnjë ankand publik të ardhshëm për parcelën ndërtimore në fjalë.
- Nëse ofertuesi më i favorshëm i paguan mjetet në përputhje me çmimin përfundimtar të ankandit brenda afatit të caktuar dhe dorëzimit të dëshmisë origjinale bashkëngjitur kërkesës dhe dëshmisë së pagesës të bërë në përputhje me çmimin përfundimtar të arritur nga ofertimi për parcelën ndërtimore të treguar në pasqyrën

- Kryetari i Komunës së Komuna e Gazi Babës në afat prej 5 (pesë) ditësh pune lidh marrëveshje me ofertuesin më të favorshëm për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me kontratë, ofertuesi (blerësi) më i favorshëm merr përsipër që brenda 9 (nëntë) muajve nga lidhja e kontratës për parcelën ndërtimore, e cila ka një sipërfaqe deri në 5000 m², të sigurojë leje për ndërtimin e objektit të planifikuar në përputhje me planin urbanistik sipas të cilit tjetërsohet toka. Me kontratë, ofertuesi më i favorshëm merr përsipër ta ndërtojë objektin në përputhje me planin urbanistik sipas të cilit toka tjetërsohet brenda një afati në përputhje me dispozitat e Ligjit të ndërtimit dhe në përputhje me kategorizimin e ndërtimit, në të kundërtën, nëse blerësi nuk merr leje ndërtimi brenda afatit të caktuar, d.m.th nëse objekti nuk ndërtohet brenda afatit të caktuar për faj të blerësit, ai do të ketë detyrimin të paguajë një gjohë kontraktuale në masën 1,5% të shumës së përgjithshme të çmimit të arritur të ankandit publik për tokën në fjalë për çdo muaj që ka kaluar në vitin e parë të skadimit të afatit, pra 3 % të shumës së përgjithshme të çmimit të arritur të ankandit publik për tokën në fjalë për çdo muaj të kaluar në vitin e dytë nga skadimi i afatit, pra 4,5% të shumës së përgjithshme të çmimit të arritur të ankandit publik të tokës në fjalë për çdo muaj të kaluar në të tretën dhe çdo vit pasardhës nga skadimi. Mospëmbushja e këtyre detyrimeve, dmth pas rënies në vonesë në përbushjen e këtyre detyrimeve për tre muaj radhazi nga ana e blerësit, përbën bazën për tjetërsuesin, pas tre muajsh thirrje mujore të njëpasnjëshme për ekzekutim, si kreditor me deklaratë për mospëmbushje të detyrimit e kontratës për të kërkuar konfirmimin e zbatueshmërisë së kontratës, pra për të kërkuar mbledhjen e dënimt kontraktor dhe është bazë për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, ku 80% e shumës totale të tjetërsimit nuk i kthehet blerësit.
- Toka ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila është lëndë e kësaj shpallje, nuk mund të jetë pjesë e pasurisë së falimentimit densa të përbushen detyrimet nga kontrata.
- Për parcelat ndërtimore me qëllim A1-banimit në shtëpi familjare, ofertuesi (blerësi) më i favorshëm merr përsipër të ndërtojë të paktën 50% të sipërfaqes totale të ndërtimit të zhvilluar të parashikuar nga plani urbanistik për parcelën ndërtimore.
- Për parcelat ndërtimore me qëllim A2 - banim në ndërtesa banimi, ofertuesi (blerësi) më i favorshëm merr përsipër të ndërtojë të paktën 80% të sipërfaqes totale të ndërtimit të zhvilluar të parashikuar nga plani urbanistik për parcelën ndërtimore.
- Ofertuesi (blerësi) më i favorshëm merr përsipër të paguajë tatimin në shifra të pronës së paluajtshme që do të lindë si detyrim pas marrëveshjes së lidhur për tjetërsimin e tokës ndërtimore.
- Pas lidhjes së kontratës, komuna e Gazi Babës e dorëzon në mënyrë elektronike në afat prej 1 (një) dite në Qytetin e Shkupit-Sektorit për çështje financiare për përcaktimin e tatimit në shifra të patundshmërie. Blerësi është i detyruar që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit për përcaktimin e taksës së shifra të pasurisë së paluajtshme të paguajë tatimin dhe të paraqesë vërtetimin e pagesës.
- Pas dorëzimit të vërtetimit të pagesës së taksës së shifra të pasurisë së paluajtshme, blerësi dorëzon në mënyrë elektronike kontratën tek noteri brenda 30 (tridhjetë) ditëve për kryerjen e procedurës së formalizimit. Blerësi është i detyruar të kryejë solemnizimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i kontratës tek noteri kompetent.
- Mospëmbushja e detyrimeve nga pikat 24 dhe 25 të këtij njoftimi për faj të blerësit përbën bazën për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, ku 80% e çmimit total nuk i kthehet blerësit.
- Në çmimin për tjetërsim nuk është përfshirë kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore.
- Shpenzimet e procedurës materiale dhe futja e patundshmërisë në regjistrin e patundshmërie në Agjencinë e kadastrës së patundshmërie të Republikës së Maqedonisë së Veriut i bartë blerësi i tokës ndërtimore. Në rast të zgjidhjes së kontratës për shkak të përfaqësimit të blerësit, ai detyrohet të paguajë tatimin mbi shifren dhe shpenzimet materiale.
- Blerësi i tokës ndërtimore të fituar në procedurën e tjetërsimit me ankand publik nuk mund t'ua kalojë të tretëve. Ndalimi i kallimit të të tretët shënohet në librin publik të regjistrimit të të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme. Mospëmbushja e këtij detyrimi përbën bazën për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, ku 80% e çmimit total nuk i kthehet blerësit.
- Blerësi i tokës ndërtimore të fituar në procedurën e tjetërsimit me ankand publik nuk mundet, pa pëlqimin paraprak, të lërë peng ose të ngarkojë ndryshe tokën dhe objektet që do të ndërtohen në të, deri në përfundimin e ndërtimit dhe fshirjen e shënimit nga pika 28 në librat publikë. Ky ndalim është shënuar në librat publikë.
- Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund t'i deklarojnë kundërshtim Komisionit në afat prej 3(tre) ditësh nga data e mbajtjes së ankandit publik elektronik. Kundërshtimi i paraqitur me shkrim Komisionit, i cili është i detyruar të vendosë me Vendim në afat prej 5 / (pesë) ditë pune nga marrja e tij. Pala ka të drejtë të ankojë në Komisionin shtetëror për vendimarrje në procedurë administrative dhe procedurë e punës nga shkalla e dytë në afat prej 15/ (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit.
- Në rast të gabimit në përkthimin në gjuhën shqipe do të merret parasysh shpallja e publikuar në gjuhën maqedonase.
- Kjo shpallje do të publikohet edhe në ueb faqen e Komunës së Gazi Babës www.gazibaba.gov.mk.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik ekskluzivisht në formë elektronike në ueb faqen www.gradezno-zemjiste.mk (shih udhëzimet në ueb faqen e Komunës së Gazi Babës - www.gazibaba.gov.mk), e cila tregon se cilës parcelë i referohet vetë fletëparaqitja dhe cilat dokumente janë pjesë përbërëse e fletëparaqitjes (për secilin parcelë individualisht), e plotësuar me dëshmitë e mëposhtme në formë të skanuar:
1. Fletëparaqitje të plotësuar në formë elektronike nga parashtruesi në ueb-faqen www.gradezno-zemjiste.mk, në të cilin janë të specifikuar të dhënat të cilave u referohet, si dhe çfarë dorëzohet përveç fletëparaqitjes (cilat dokumente);
2. Për personat fizik certifikatë shtetësie në formë të skanuar, jo më e vjetër se 6 muaj nga afati i parashtrimit të fletëparaqitjes;
3. Për personat juridikë vërtetim për regjistrimin e personit juridik nga regjistri përkatës në formë të skanuar (Ekstrakt nga gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut jo më i vjetër se 30 ditë nga afati për parashtrimin e fletëparaqitjes);
4. Autorizim të noterizuar në formë të skanuar për të autorizuarin që përfaqëson ofertuesin, nëse fletëparaqitja është dorëzuar nëpërmjet një të autorizuarit;
5. Garancia bankare e skanuar për seriozitetin e ofertës në shumën e përcaktuar në pasqyrën tabelore për çdo parcelë ndërtimore individualisht, me afat vlefshmërie 30.12.2023, me të cilën ofertuesi garanton se nëse fiton statusin e ofertuesit më të favorshëm do të paguajë çmimin e shumës përfundimtare për tjetërsimin e tokës ndërtimore të ankandit publik elektronik brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për përgjydhjen, e njëjta duhet të dorëzohet në formë elektronike si dhe në origjinal përmes arkivit pranë Komunës së Gazi Babës deri të Komisioni për zbatimin e procedurave për ankand publik në zarf të bardhë të shënuar "mos hap" dhe referuar numrit të shpalljes publike deri në afatin e paraqitjes.

SHËNIM: Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik dorëzohen EKSKLUZIVISHT NË MËNYRË ELEKTRONIKE në ueb faqen www.gradezno-zemjiste.mk, të kompletuara duke i bashkangjitur dëshmitë e përmendura në formë të skanuar. Udhëzimet e hollësishme për mënyrën e aplikimit në mënyrë elektronike janë të publikuara në ueb-faqen e Komunës së Gazi Babës - www.gazibaba.gov.mk. Komuna e Gazi Babës nuk do të pranohet fletëparaqitjet e dorëzuara me postë apo përmes arkivit pranë Komunës së Gazi Babës. Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankand publik elektronik, për të cilin do të njoftohen në mënyrë elektronike dorëzuesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara. Personat e interesuar (fizik dhe juridik) DUHET TË KENË CERTIFIKATË DIGJITALE që të mund të parashtrorin fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik dhe të marrin pjesë në ankandin publik elektronik.

ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik për parcelat ndërtimore me qëllim A1-banim në shtëpi familjare është 61,00 denarë për metër katror.
Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik për parcela ndërtimore me qëllim A2-banim në ndërtesa banimi është 2.340,00 denarë për metër katror.

GARANCIA BANKARE

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës përcaktohet për çdo parcelë ndërtimi individualisht sipas pasqyrës tabelare të dhënë në këtë shpallje dhe të gjithë personat fizikë dhe juridikë të paraqitur janë të detyruar të paraqesin garancinë bankare krahas versionit të skanuar elektronik dhe në origjinal përmes arkivit në Komunën e Gazi Babës në përfundim të afatit të paraqitjes.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik për parcelat ndërtimore të shënuara në pasqyrën tabelare duhet të dorëzohen deri më 18.12.2023, ora 23:59, në mënyrë elektronike në adresën e mëposhtme të internetit: www.gradezno-zemjiste.mk.
Ankand publik do të mbahet në mënyrë elektronike në ueb faqen e mëposhtme www.gradezno-zemjiste.mk
Ankand publik do të zhvillohet më 20.12.2023 dhe nuk mund të zgjasë më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta si më poshtë:
Në ora 10:00 për P. N nr. 3.13 me qëllim A1- banim në shtëpi familjare.
Në ora 10:15 për P. N nr. 4.34 me qëllim A1- banim në shtëpi familjare.
Në ora 10:30 për P. N nr. 4.35 me qëllim A1- banim në shtëpi familjare.
Në ora 10:45 për P. N nr. 4.36 me qëllim A1- banim në shtëpi familjare.
Në ora 11:00 për P. N nr. 11.4 me qëllim A2- banim në ndërtesa banimi.
Në ora 11:15 për P. N nr. 11.5 me qëllim A2- banim në ndërtesa banimi.
Në ora 11:30 për P. N nr. 11.6 me qëllim A2- banim në ndërtesa banimi.